



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 244/11 prot.

Datë 25.02.2026

V E N D I M
Nr. 312/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.02.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 214/2026, datë 09.02.2026 për procedurën e prokurimit prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Lushnje Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Shoqeria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lushnje Sh.A.
Lagja “18 Tetori”, Lushnje

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin

e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 214/2026, ku vendosi:

“[....]

- 1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetles Kanalizime Lushnje Sh.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
- 5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.. [....]”

I.2. Me shkresën nr. 66/11 prot., datë 11.02.2026, protokolluar me tonën nr. 244/7 prot., datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetles Kanalizime Lushnje Sh.A njofton se ka zbatuar vendimin Nr.214/2026, datë 09.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat

12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjes Kanalizime Lushnje Sh.A., duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 66/11 prot., datë 11.02.2026, protokolluar me tonën nr. 244/7 prot., datë 12.02.2026, autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjes Kanalizime Lushnje Sh.A njofton se ka zbatuar vendimin Nr.214/2026, datë 09.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjes Kanalizime Lushnje Sh.A., duke i bashkëngjitur shkresës edhe shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se shtojca nuk është publikuar në SPE.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjes Kanalizime Lushnje Sh.A e nuk e ka zbatuar vendimin vendimin Nr. 214/2026, datë 09.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi pasi nuk e ka publikuar në SPE shtojcën me modifikimet e dokumenteve të tenderit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Mall”, me REF-74312-01-22-2026 me objekt: “Blerje Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi për nevojat e shoqërisë”. – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara,

me afat 12 muaj”, me fond limit 2 350 155 (Dy milion e treqind e pesëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 06.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqeria Rajonale Ujësjeljes Kanalizime Lushnje Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike shtojcën me modifikimet përkatëse sipas përcaktimeve në vendimin nr. 214/2026, datë 09.02.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik

3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

